

AKT THEMELIMI

I shoqërise tregtare SORRIDI LAB. INNOVATION SH.P.K

Sot, më 05.09.2024, mbështetur në Kushtetuten dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Për shoqërite tregtare" dhe të ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqërite Tregtare, me vullnetin e tyre të lire, të shprehur edhe në nenshkrimin e këtij akt-themelimi ne ortaket :

- 1- **Z. Gentjan Radani** i biri i Flamur, person fizik me numer personal **I81008015N**, banues në Tirane.

të krijojnë shoqërine tregtare me përgjegjesi të kufizuar **SORRIDI LAB. INNOVATION sh.p.k** me akt themelimi si vijon:

Neni 1

Formulimi

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur **SORRIDI LAB. INNOVATION sh.p.k**. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqëria do të ushtroje veprimtarine e saj në baze të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërise që do të miratohet nga ortaket themelues.

Neni 2

Selia e Shoqërise

Selia e shoqërise tregtare private do të jetë në **Tirane, Rruga Irfan Tomini, Pallati nr. 8, apartamenti 6**. Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra përfaqesie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblese së ortakeve.

Neni 3

Objektivi i Veprimtarise

Shoqëria do të zhvillojë aktivitete në fushen e :

- *Ushtrimi i aktivitetit si guide dhe asistimi i klienteve për turizem dentar.*

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërise do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shpërbëhet në çdo kohe dhe për çfardo lloj shkakut .



Neni 5

Kapitali i Shoqërise

Kapitali i shoqërise është 100,000. Leke(njeqind mije lek) i përbëre nga 1 (nje) kuote dhe zoterohet nga ortaku i shoqërise si më poshte :

Ortaku Themelues: Gentjan Radani, zoterues i 1 kuote me vlere te pergjithshme 100.000 lek, te cilat perfaqesojne 100 % te kapitalit te shoqerise.

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar 100,000 Lek

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar 100.000 Lek

Neni 6

Drejtimi i Shoqerise

Shoqëria do të drejtohet nga administratori Gentjan Radani i cili është përfaqesues ligjor i saj. Administratori është përfaqesues i Shoqërise në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e tij.

Çdo kontrate do të kryhet prej tij dhe në rast mungese, nga një përfaqesues i pajisur me prokure të posaçme .

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqerise i takojne ortakeve të shoqerise.

Neni 8

Ortaket themelues të shoqerise kane të drejte të emeroje dhe administratore të tjerë te vlerave material. Kane të drejte të caktoje financiere, likuidator për problemet e shoqërise si dhe të pajtoje persona të tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet që mund te lindin do të zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqipetar ne Gjykatën e Rethit Gjyqësor Tirane.

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar ne zbatim të plote të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipetar në fuqi dhe veçanerisht të Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqeri.



Neni 12

Akti i themelimit u përpilua në 4 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë **SORRIDI LAB. INNOVATION sh.p.k.**

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

Ortakët Themelues Të Shoqërisë

SORRIDI LAB. INNOVATION sh.p.k

GENTJAN RADANI

